

REPUBLIKA SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

P/V E N D I M

Nr. 07 Date 02.04. 2012

Per

**Miratim te Lejes se Perdoritimit te ujit per nevoja teknologjike subjekti “Vllaznimi -Deda” shpk
Preng Zefi, burimi uJOR Liceni Sopajve, sipas kerkeses se ketij subjekti:**

- Ne mbeshtetje te nenit 8 pika 1, neni 18 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore”, te Vendimit K.M. Nr. 27 date 19.01.2007, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve, Kreu XI, pika 9, me propozim te A.U.B. Mat per paisjen me leje Perdorimi te Rezerves Ujore shoqerise “Vllaznimi-Deda”shpk, sipas kerkeses date 02/10/2011 ,
Keshilli i Basenit Mat,

VENDOSI:

1- Miratimin e kerkeses se **Zotit Preng Zefi, administrator i “Vllaznimi-Deda” shpk** per dhenie Leje Perdorim Rezerva Ujore per larje mineralesh. Nga verifikimi ne vend rezultoi se kjo leje nuk perben konflikt me perdoruesit e ujit per energji ne skemen energjitike te Perroit Licone dhe basenit Drin-Bune qe ka te beje me perdorimin e ujit nga Liqeni Sopajve. Kerkesa per Leje Perdorimi uji per nevoja teknologjike permban keto te dhena:

-Subjektit juridik/fizik: “Vllaznimi-Deda”

-Prurja mesatare: Q=4 lit/sek,

-Kordinata VM 1550 m, X=4585960, Y=4442270,

-Kordinata impiantit 1550m, X=4587500, Y=4440300.

2- Personi fizik/juridik “Vllaznimi-Deda”shpk me administrator zoti Preng Zefi eshte e vlefshme ne se nuk demton interesat e komunitetit per perdorim uji per nevoja per vaditje, per uje te pijshem, e tjere perdorime te rezervave ujore sipas ligjit. Keto jane arsye qe perbejne shkak anullimin e kesaj leje ne menyre te menjehereshme.

3- Ky vendim hyn ne fuqi mbasi te shprehet Drejtoria Teknike ne MMPAUjrave Tirane, duke plotesuar te gjitha kerkesat e ligjshme nga Bordi Kullimit dhe nga Pushteti Vendor.

PERGJEGJES I A.U.B. MAT

Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT

Pal DAJCI

